

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar i kolegjit, Gani Avdiu dhe Ramë Hyseni, anëtarë në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Sh.G. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Insig” sh.a me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.D., për rimbursimin e dëmit, vlera 4,757.33 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.327/2013 i datës 30.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Insig” sh.a me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, .C.nr.327/2013 i datës 30.10.2015, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “Sigma” dhe e ka detyruar të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “Insig” sh.a në Prishtinë që në emër të kompensimit të rimbursimit t’ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve në lartësi prej 4,757.33 euro, së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3.5%, e cila do të llogaritet nga data e pagesës së dëmit 05.01.2011 e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 320.40 euro, në afat prej 7 ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, ta ndryshojë ose ta prish dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja Kompania e Sigurimeve "Siguria", me seli në Prishtinë, me datën 25.06.2013 ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar rimbursimin e dëmit të pësuar nga aksidenti i datës 24.03.2010 në shumën prej 4.470 €, me kamatë ligjore duke filluar nga data e pagesës së dëmit me datë 05.01.2011.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke vlerësuar raportin policor të datës 24.03.2010 dhe mendimin e konstatimin e ekspertit të komunikacionit Y.K. të dhënë me ekspertizën e datës 20.10.2014 nga e cila ka vërtetuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit të kamionit të markës "Mercedes" të siguruar te e paditura dhe se dëmi i shkaktuar paditësit është në lidhje kauzale me veprimet e të siguruarit të të paditurës, ku me rastin punimeve në rrugë nuk kanë ndërmarrë masa siguruese për sigurinë e mjeteve të cilat kanë lëvizur nga ana e kundër e rrugës, duke konstatuar kështu që i siguruari i të paditurës ka qenë shkaktar për aksidentin e datës 24.03.2010 ndërsa për lartësinë e dëmit të pësuar gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ekspertizën teknike të ekspertit N.Sh., ku dëmi real i pësuar nga aksidenti kap shumën prej 4,757.33 euro, dëm ky i vlerësuar nga pjesët e dëmtuara në automjet sipas çmimit mesatarë të marra nga shitoret e auto-pjesëve dhe serviset e autorizuara për këtë markë, dhe tip të automjetit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i vlerësoi pretendimet ankimore sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara ngase ekspertiza e komunikacionit e datës 20.10.2014 në mënyrë të detajuar tregon se faji i shkaktimit të aksidentit i takon ekskluzivisht të siguruarit të së paditurës, madje për të evituar paqartësitë e mundshme të ekspertizës së komunikacionit sipas të paditurës gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar propozimin për super ekspertize, por e paditura në seancën e datës 12.05.2015 ka hequr dorë nga ky propozim i saj duke mos ofruar prova të tjera që do ti bazonte pretendimet e saja, andaj dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin ekspertizës në fjalë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së paditurës, lidhur me zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara ngase me ekspertizën teknike të datës 30.09.2015 është vlerësuar drejtë dëmi real i pësuar nga aksidenti i datës 24.03.2010 i cili mbërrin në shumën 4,757.33 euro, i llogaritur në bazë të gjetjeve të ekzaminimit të automjetit të dëmtuar, ndërsa lartësia e dëmit drejtë është vlerësuar sipas çmimit mesatarë të marrë nga auto-pjesët e serviset e autorizuara në Kosovë për këtë tip të automjetit, e pasi që nga ekspertiza është vërtetuar se fajtor për shkaktimin e aksidentit është automjeti i siguruar te e paditura, si dhe nga konstatimi i ekspertit për lartësinë e dëmit të pësuar gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kolegji i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kolegji i Gjykatës së Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,  
Ae.nr.23/2016, me datë 14.02.2018.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari  
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v.